



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**

NJËSIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 13-111/01-0084805/23

Dt. 30.11.2023

Bazuar në Nenet 77, 80, 81 të Ligjit Nr. 08/L-197 Për Zyrtarët Publik, Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, në mbështetje të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, si dhe në bazë të kërkesës së QKMF-së me Nr.13-111/01-0084478/23, Njësia e Burimeve Njerëzore shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

I.Pozita: Mjek/e i/e Përgjithshëm në QKMF Podujevë, 6 (gjashtë) pozita

Koeficienti: H10 - 7.4

Lloji i vendit të punës: Me afat të pacaktuar, me orar të plotë (Periudha provuese 6 muaj)

Përshkrimi i detyrave të punës:

- Ofron mbrojtjen primare shëndetësore për pacientin dhe familjen;
- Pranon pacientin nga Infermierja, shkruan të dhënat në kartelën shëndetësore, merr anamnezën, bënë ekzaminimin e pacientit (inspektimin, auskultimin, palpacionin dhe perkusionin), reanimimin kardio pulmonar dhe referon pacientin për hulumtime të tjera dijagnostike;
- Bën diagnozën initiale dhe trajtimin me terapi adekuate;
- Udhëzon tek specialisti konsultant nëse është e nevojshme konsulta;
- Kryen shërbime në kuadër të shëndetit reprodutiv, kujdesit antenatal dhe postnatal;
- Bën imunizimin (vaksinimin);
- Promovon edukimin shëndetsor;
- Trajton lëndime të vogla;
- Kryen vizita shtëpiake kur është e domosdoshme;
- Bën identifikimin e grupeve vulnerable dhe të rrezikuara;
- Bën dhënjen e barërave dhe medikamenteve esenciale;
- Gjatë punës së tij i asistojnë infermierët;
- Për punën e vet i përgjigjet Kryeshefit të DMF-së dhe Drejtorit.

Kualifikimi i kërkuara:

- Diploma e Fakultetit të Mjekësisë - Drejtimi i Përgjithshëm;
- Licencë përkatëse të lëshuar nga organi kompetent;

II. Pozita: Teknik/e i/e Rentgenit, 1 (një) pozitë**Koeficienti: H20 - 5.1 ; H17- 5.4****Lloji i vendit të punës: Me afat të pacaktuar, me orar të plotë (Periudha provuese 6 (gjashtë) muaj.****Përshkrimi i detyrave të punës:**

- Përgaditë pacientët për incizime radiologjike;
- Bën përgaditjen e nevojshme të aparaturës;
- Bën incizimin dhe përpunimin teknik të filmit;
- Është përgjegjës për shfrytëzimin sa më racional të filmave;
- Bën kërkesat për furnizim me material hargjues;
- Radiografitë duhe t'i bëjë në mënyrë profesionale;
- Kujdeset për mjetet e punës, mban dozimetrimin, mban mjetet mbrojtëse për vetën dhe pacientin;
- Zbaton detyrat e deleguara nga menaxheri në pajtueshmëri me politikat shëndetësore në fuqi;
- Obligohet të zbatojë programin e vazhdueshëm të edukimit shëndetësor;
- Për punën e vet i përgjigjet kryeinfermierit, shefit të shërbimit dhe Drejtorit.

Kualifikimi i kërkuara:

- Diplomë e Shkollës së Mesme të Mjekësisë në drejtimin Teknik Rentgeni apo Bachelor në drejtimin Teknik Rentgeni;
- Licencë përkatëse të lëshuar nga organi kompetent.

III. Pozita: Teknik/e Laborant/e, 2 (dy) pozita**Koeficienti: H20 - 5.1 ; H17- 5.4****Lloji i vendit të punës: Me afat të pacaktuar, me orar të plotë (Periudha provuese 6 (gjashtë) muaj.****Përshkrimi i detyrave të punës:**

- Bën pranimin dhe evidentimin e pacientëve, të cilët me udhëzime të mjekëve vijnë për analiza laboratorike;
- Bën pranimin e materialit për analiza;
- Vendos sendimentacionet dhe përcakton vlerat;
- Bën leximin e pasqyrave të gjakut;
- Pranon urinat, i punon dhe bënë etiketimin e tyre;
- Bën leximin e sendimentacionit të urinës në mikroskop;
- Kryen analizat biokimike siç janë: Glikemia, Urea, Kreatinina, Holesteroli, Trigliceridet, ALT- AST, Hepatogrami (dhe të gjitha të tjerat që janë të realizuara, që kryhen në laboratorin ku sistemohet);
- Sterilizon mjetet e punës;

-Për punën e vetë i përgjigjet përgjegjësit të laboratorit, kryeinfermierit dhe Drejtorit.

Kualifikimi i kërkuara:

- Të ketë të përfunduar Shkollën e Mesme të Mjekësisë në drejtimin Teknik Laboratori apo Bachelor në drejtimin Teknik Laboratori;
- Licencë përkatëse të lëshuar nga organi kompetent.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR TË GJITHË KANDITATËT

Kërkesat e përgjithshme për pranim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

Dokumentet e Kërkuara:

- Diploma e kualifikimit përkatës;
- Dëshmia e Licencës;
- Kopja e Letërënjoftimit;
- Çdo dokument tjetër apo certifikatë trajnimi;
- Dokument që dëshmon që nuk jeni i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale (nga Gjykata);
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor që dëshmon se gjendja e kandidatit është pa probleme shëndetësore (Kjo dëshmi sillet pas pranimit në mardhënje pune të kandidatit);
- Dokumentet i dërgoni fotokopje sepse të njëjtat nuk kthehen.

AFATI I APLIKIMIT:

Afati për paraqitjen e aplikacioneve është 30 ditë, nga data 01.12.2023 deri me datën 30.12.2023.

Përveç web faqes unike të procedurave të konkurimit, konkursi publikohet edhe në web-faqe zyrtare të Komunës.

Komuna e Podujevës ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Fletëaplikacionet merren në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë, në ndërtesën e Komunës së Podujevës.

Kërkesat me dokumente të kompletuara dorëzohen në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë.

Për çdo informatë plotësuese mund të kontaktoni në Njësinë e Burimeve Njerëzore, në këtë numër të telefonit 038 200 41-014.

Rezultatet shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/>